DOGANA E KOSOVËS - CARINA KOSOVA - KOSOVA CUSTOMS
27. 05. 2024 DALJE - IZLAZ - PASSING
Nr/Br/No. 01/492/2024
Drejtoria Qendrore - Opšta Uprava - Central Administration

Arkiva - Arhiva - Archive
01/02 1417/2024
27/05/2024

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
### *Qeveria – Vlada - Government*

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarsvo za Finansije, Rada i Transfera – Ministry of Finance, Labour and Transfers*

**Nr. 31/2024**
**Datë: 27.05.2024**

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 374 dhe 377 të Kodit Doganor dhe Akcizave, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve nxjerr këtë:

**VENDIM**

1. Dërgesat me mallra që dërgohen drejtpërdrejt nga një vend jashtë Kosovës te një pranues në territorin doganor të Republikës së Kosovës, me vlerë të përgjithshme që nuk tejkalon shumën prej tridhjetë e pesë euro (€35) për secilën dërgesë, lirohen nga detyrimet e importit.

2. Në vlerën e përgjithshme te dërgesave nga blerjet online nga personat fizikë në shumën prej tridhjetë e pesë euro (€35) përfshihet vetëm çmimi i paguar për mallin ne vetvete, dhe jo shpenzime të tjera si ato të transportit, sigurimit etj.

3. Dërgesat me mallra me natyrë jo-tregtare që dërgohen nga një person fizik te një pranues fizik për përdorim personal në territorin doganor të Republikës së Kosovës, me vlerë të përgjithshme që nuk tejkalon shumën prej pesëdhjetë euro (€50), lirohen nga detyrimet e importit.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Hekuran Murati**

Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

Vendimi iu dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm të MFPT-së;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Doganës së Kosovës; dhe
- Arkivit të MFPT-së.